



### **Përditësim për shtypin**

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Dëshiroj të filloj me një koment në përgjigje të raportimeve çorientuese dhe të pasakta në disa media si dhe të deklaratave të Avokatit të Popullit të Kosovës lidhur me një raport të përgatitur nga Komiteti i të Drejtave të Njeriut i Dhomës së Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit, me kërkesë të Zyrës së Avokatit të Popullit të Kosovës.

Në kundërshtim me atë që u raportua në media, raporti i këtij Komiteti nuk përmban asnjë konstatim se ndonjë vendim i gjykatësve të Dhomave të Specializuara ka shkelur të drejtat e njeriut të të akuzuarve dhe në të nuk nxirret asnjë përfundim se jurisprudenca e Dhomave të Specializuara shkel apo bie ndesh me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut apo ndonjë tribunal ndërkombëtar *ad hoc*, përfshirë TPNJ-në. Po kështu, raporti nuk përmban asnjë konstatim se vendimet mbi paraburgimin kanë qenë në shkelje të ndonjë konvente të të drejtave të njeriut. Faktikisht, në raport trajtohet disponueshmëria efektive e mjeteve juridike në Dhomat e Specializuara dhe thuhet se shumë aspekte janë ende duke u shqyrtuar nga gjykatësit dhe mund të apelojnë në instanca më të larta.

Duhet theksuar më tej se shumë nga aspektet e ngritura prej Avokatit të Popullit të Kosovës dhe të trajtuara në raportin e Komitetit në fjalë, bazohen kryesisht në argumente të marra nga parashtrimet e ekipeve të Mbrojtjes. Aty nuk trajtohen qëndrimet e Prokurorisë dhe të Mbrojtjes së Viktimave, dhe as arsyetimet konkrete të paneleve në vendimet përkatëse.

Në Raport pranohet shprehimisht se shumë nga aspektet e trajtuara aty janë ende në proces diskutimi juridik dhe, për rrjedhojë, gjykatësit ende nuk kanë marrë vendime për to.

Dhomat e Specializuara shfrytëzojnë këtë mundësi për të rikujtuar rolet e dallueshme të palëve në proces. Mbrojtja përfaqëson dhe mbron interesat e të akuzuarve në procesin gjyqësor. Mbrojtja e Viktimave përfaqëson dhe mbron interesat e viktimave pjesëmarrëse. Prokuroria ka detyrimin e vërtetimit të akuzave që ka ngritur. Megjithatë, vetëm trupi gjykues është ai që vendos për faktet, vlerëson provat dhe vendos nëse fajësia është vërtetuar jashtë dyshimit të arsyeshëm. Të gjitha vendimet mund të apelojnë. Rrjedhimisht, për të kuptuar drejt dhe saktë punën e Dhomave të Specializuara, i duhet kushtuar vëmendje e veçantë arsyeve të plota të paraqitura në vendimet e gjykatësve, jo vetëm qëndrimeve të paraqitura nga njëra prej palëve.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se as Avokati i Popullit i Kosovës dhe as Komiteti i të Drejtave të Njeriut të Dhomës së Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit nuk janë pjesë e Dhomave të Specializuara dhe se ky raport nuk do të ketë asnjë ndikim në punën e Gjykatës.





Të flasim tani për zhvillimet në Gjykatë.

Në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët*, lidhur me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, më 5 maj Trupi Gjykses lëshoi një urdhër në të cilin zgjati afatin e shqiptimit të Aktgjykimit me 60 ditë, deri më 20 korrik 2026. Trupi Gjykses konstatoi se rrethanat e çështjes gjyqësore kërkojnë kohë shtesë, duke cituar volumin e madh të provave dhe kompleksitetin e procesit. Dua të qartësoj se 20 korriku nuk është data për shqiptimin e Aktgjykimit, por vetëm data e re deri në të cilën është zgatur afati kur mund të lëshohet Aktgjykimi. Trupi Gjykses theksoi se, në qoftë se një zgjatje e re e afatit do të jetë absolutisht e domosdoshme, ai do të lëshojë urdhër për këtë në kohën e duhur.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit lidhur me pretendime për ndikim ndaj dëshmitarëve, dëshmitari i fundit në këtë gjykim, i thirrur prej Mbrojtjes së Thaçit, pritet të japë dëshmi javën nga 11 deri në 15 maj. Kjo u njoftua në një vendim të Gjykatësit të Vetëm më 29 prill, që u bë publik më 4 maj. Në atë vendim, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi ekipet e Mbrojtjes që të mbyllnin paraqitjen e provave deri të enjten, 14 maj 2026, dhe shtoi se ekipet e Mbrojtjes do të lejoheshin të paraqisnin prova shtesë në varësi të vendimit të apelit mbi prova specifike që janë kërkuar të pranohen nga Prokuroria.

Më tej, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi Prokurorinë që të dorëzojë kërkesa për pranimin e kundërprovave të mundshme jo më vonë se deri më 15 maj.

Gjithashtu, Gjykatësi i Vetëm informoi palët se duhet të përgatiten të dorëzojnë dosjet përfundimtare deri të premten, 19 qershor, dhe se deklaratat përmbyllëse do të mbahen 21 ditë më pas. Gjykatësi i Vetëm theksoi se konfirmimi i këtyre datave varet nga vendimet që do të jepen në lidhje me disa apele të ndërmjetme.

Më 1 maj u bë publik një vendim i Gjykatësit të Vetëm i datës 27 mars, në të cilin rrëzoi kërkesën e Prokurorisë për pranimin e aktekspertizës së një dëshmitari ekspert që dha dëshmi në mars të këtij viti. Dëshmitari nuk pranoi t' u përgjigjej disa pyetjeve për metodologjinë që kishte përdorur, për arsye konfidencialiteti. Gjykatësi i Vetëm e konstatoi aktekspertizën të papranueshme, pasi metodat e përdorura nuk ishin mjaftueshmërisht të qarta për të mundësuar vlerësim të plotë të vlerës provuese të saj. Gjykatësi arriti në përfundimin se pranimi i aktekspertizës do të dëmtonte Mbrojtjen dhe, për rrjedhojë, refuzoi ta pranonte si provë. Megjithatë, Gjykatësi i Vetëm pranoi si provë dëshminë gojore të dëshmitarit ekspert.

Në të njëjtin vendim, Gjykatësi i Vetëm miratoi një kërkesë të ekipeve të Mbrojtjes të z. Kilaj dhe z. Smakaj për shtim të numrit të fjalëve për një mocion të përbashkët në lidhje me aktekspertizën e ekspertit, në të cilën informuan se Prokuroria nuk e kundërshtonte kërkesën dhe se mocioni ishte brenda numrit të gjithsejtë të fjalëve që do të bëhej në qoftë se secili ekip i Mbrojtjes do të dorëzonte kërkesë më vete, siç kanë të drejtë të bëjnë.





Gjithashtu më 1 maj u bë publik një vendim i 22 prillit, me të cilin Gjykatësi i Vetëm nuk pranoi si provë një aktekspertizë që Mbrojtja e Thaçit kishte kërkuar të pranohej si provë materiale më vete, e palidhur me ndonjë dëshmi dëshmitari. Gjykatësi i Vetëm konstatoi se nuk ishte e përshtatshme që aktekspertiza të pranohej, sepse aty bëhej interpretim ligjor pikërisht i atyre dispozitave të Kodit Penal të Kosovës që duhet të zbatohen në këtë çështje gjyqësore. Gjykatësi i Vetëm bëri dallimin e qartë midis aktekspertizave, në të cilat mund të trajtohen aspekte faktike ose të një ligji të huaj, dhe interpretimit të dispozitave ligjore të zbatueshme, që janë tërësisht kompetencë e gjykatësit.

Më 1 maj u bë publik gjithashtu një vendim i 14 prillit, me të cilin Gjykatësi i Vetëm miratoi kërkesën e Fadil Fazliut për ndryshimin e kushteve të lirim, duke e lejuar atë të kishte përsëri kontakte me djalin e tij, Fahri Fazliun. Gjykatësi i Vetëm rikujtoi se kufizimi i kontaktit ishte vendosur për shkak të rrezikut që z. Fazliu mund të ndikonte, qëllimisht ose jo, tek i biri, i cili nga ana e tij mund të kontaktonte dëshmitarë të mundshëm të Mbrojtjes. Sipas Gjykatësit të Vetëm, që prej asaj kohe ka pasur një numër zhvillimesh procedurale që e kanë ulur ndjeshëm këtë mundësi dhe, rrjedhimisht, arsyet që përligjin kufizimin nuk ekzistojnë më.

Më 4 dhe 5 maj u bënë publikë vendime të Gjykatësit të Vetëm të datave 12 shkurt dhe 23 mars, me të cilët ai miratoi pjesërisht një kërkesë e Prokurorisë për pranimin e disa provave si prova materiale të pavarura, të palidhura me dëshmi të dëshmitarëve. Gjykatësi i Vetëm i pranoi këto prova materiale pasi konstatoi se ishin relevante për çështjen gjyqësore, autentike, dhe nuk dëmtonin Mbrojtjen.

Më 5 maj Gjykatësi i Vetëm miratoi një kërkesë të z. Thaçi dhe e autorizoi atë që në seancat gjyqësore për paraqitjen e provave të Mbrojtjes të marrë pjesë përmes videolidhjes. Tani të gjithë të akuzuarit janë autorizuar t'i ndjekin seancat përmes videolidhjes.

Seancat në këtë çështje gjyqësore janë planifikuar për datat 11 deri më 15 maj, nga ora 9:30 deri në 16:30.

Së fundi, në çështjen e Pjetër Shalës, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, Ekaterina Trendafilova, caktoi më 1 maj një panel të Gjykatës Supreme për të vendosur mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmerisë kundër Vendimit mbi Apelin e Mbrojtjes kundër Urdhrit për Zhdëmtim. Paneli përbëhet prej gjykatëses Ekaterina Trendafilova, Kryegjykatëse, dhe gjykatësve Kristinë van den Vajngart dhe Daniel Fransen.

*Pyetje: Një gazetar pyeti nëse do të mbahen seancat gjatë javës 11-15 maj duke mbajtur parasysh se 11 maj është pushim zyrtar në Kosovë, zëdhënësja e DHSK-së u përgjigj se ajo të pyeste sërish dhe do të konfirmonte më vonë me shkrim se seancat e javës së ardhshme do të mbahen sipas planit.*

